



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 1451 prot.

Gjirokastrë, më 03.02.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut.

KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET
Përmet

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 1, datë 23.1.2026, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmet për vitet 2027-2029”, konfirmohet.
2. Vendimi nr. 2, datë 23.1.2026, “Për një ndryshim në VKB nr. 116, datë 17.12.2025, ‘Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar të Bashkisë Përmet dhe të institucioneve që varen prej saj për vitin 2026”, konfirmohet.
3. Vendimi nr. 3, datë 23.1.2026, “Për miratimin e kontratës së qirasë ndërmjet Bashkisë Përmet dhe subjektit ‘Vodafone’ Sha për dhënien në përdorim të fondit kullosor të një sipërfaqeje prej 0.1843 ha, në ngastrën nr. 27 të Ekonomisë Kullosore ‘Dhëmbel’, për vënie antene të telefonisë së lëvizshme, si dhe dhënien e autorizimit të kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e saj”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
4. Vendimi nr. 4, datë 23.1.2026, “Për përfundimin e procedurave lidhur me VKM-në nr. 329, datë 22.5.2019 ‘Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje për efekt regjistrimi’ dhe për lidhjen e kontratave para noterit për 2 (dy) familje”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

5. Vendimi nr. 5, datë 23.1.2026, “Për miratimin e programit kulturor dhe argëtues për vitin 2026 dhe akordimin e fondit përkatës”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

6. Vendimi nr. 6, datë 23.1.2026, “Për përcaktimin e kriterëve për familjet në nevojë nga fondi 6% dhe fondi i bashkisë”, konfirmohet.

7. Vendimi nr. 7, datë 23.1.2026, “Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë muaji janar 2026”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

8. Vendimi nr. 8, datë 23.1.2026, “Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Albana Hasanaj

